

VENDIM
Nr.249, datë 6.3.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË
KOMUNËS DROPULL I POSHTËM, TË QARKUT TË GJIROKASTRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Dropull i Poshtëm, të qarkut të Gjirokastrës, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 96 (nëntëdhjetë e gjashtë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 570 (pesëqind e shtatëdhjetë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Dropull i Poshtëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Dropull i Poshtëm

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-22	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
23-40,47,48,50,52,53,54,56,57,58	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
59-71	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
72-89	Varrezat publike	Në pronësi
90,91,141-161,280-392	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte) dhe shërbime publike	Në pronësi
92-140	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
593-598	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
221,222,224,225,227,228,230,231,232,234,235,237,238,240,241,243,244,246,247,249,250,252,253,255,256,258,259,261,262,264,265,267,268	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit, tokë bujqësore.	Në përdorim
223,226,229,233,239,242,245,248,251,254,257,260,263,266,411,421,424,438,441,452,455,466,467,481,490,494,502,504,510,514,	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit, kanale të trea dhe tokë jobujqësore.	Në pronësi

524,529,539,544,551/1/2,553/3,5 56/2,558,560/3,562/1,563/3		
270-279	Prona në fushën e furnizimit me ujë të pijshëm.	Në pronësi